



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 3, par.1, pika b të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45, të dt. 11 gusht 2000 dhe të nenit 19, par. 1, pika b të Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.3.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 24.07.2007, merr

V E N D I M

MBI CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR SHKOLLËN FILLORE DHE ATË TË MESME TË MUZIKËS DHE BALETIT “PRENK JAKOVA” NË LAGJEN “LAKËRISHTA” NË PRISHTINË

Neni 1

Miratohet Vendimi mbi caktimin e lokacionit për ndërtimin e shkollës fillore dhe asaj të mesme të muzikës dhe baletit “Prenk Jakova” në lagjen “Lakërishta” në Prishtinë.

Neni 2

Lokacioni për ndërtimin e objektit, sipas këtij vendimi, përfshihet në pjesën e ngastrës 7161, KK Prishtinë, të evidencuar në fletën poseduese nr. 10244, në një sipërfaqe rreth 90.00 arë.

Neni 3

Ky vendim paraqet bazë për dhënien e pëlqimit në lokacion, lëshimin e lejes urbanistike dhe lejimin e ndërtimit të objektit investiv për të cilin është caktuar lokacioni sipas këtij vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Bordi i drejtorëve i Komunës së Prishtinës. Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe i Ndërtimtarisë dhe Drejtorati i Kadastrit dhe i Gjeodezisë i Komunës së Prishtinës, do të kryejnë veprime nga përgjegjësitë e tyre të caktuar për realizimin e këtij vendimi.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

Nr 01. 353-307, më.24.07.2007

**KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri**